



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 831/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazic edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesë nga Fatbardha Selmani kandidatë për asamble komunale nga rradhet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) paraqitur kundër komisionereve të vendvotimit me nr.0423D/01RZ të fshatit Perlepnice (shkolla fillore “Skenderbeu”) për shkak të parregullsive të procesit të votimit dhe manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Fatbardha Selmanit (PDK) nga Gjilani.

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 12.11.2013 ka pranuar një ankesë nga Fatbardha Selmani, në të cilën theksohet se në qendren e votimit në fshatin Perlepnice respektivisht në shkollën fillore “Skenderbeu” vendvotimi me nr.0423D/01R, dyshohet se është bërë manipulim i votave dhe vjedhja e tyre, në këto qender. Andaj kërkojmë nga PZAP-i që të bëjë hapjen e kutisë së votimit, pasi që votuesit kanë deklaruar që me plotë përgjegjësi penale dhe materiale do të deklarohen edhe prane organeve të drejtësisë për manipulimin e këtyre votave. Ata kanë deklaruar se në këto vendvotim kanë votuar 9 votues për PDK-në duke votuar numrin 99, si dhe duke votuar nr.36 Fatbardha Selmanin kandidatë për asamble komunale nga PDK-ja kurse në vendvotimin e lartcekur ka dalë vetëm një votë, njëkohsisht kërkojmë që kryesi i veprës të ndiqet penalisht për falsifikim të rezultateve të votimit, konform nenit 219 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga dëshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se antaret e qendres së votimit nr.0423D/01R të shkollës fillore “Skenderbeu” të fshatit Perlepnice komuna e Gjilanit, kanë bërë manipulimin e votave gjatë procesit zgjedhor, PZAP-i i vlerëson si pabazuar dhe të pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 831/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**

***Këshillë Juridik:***

Ndaj ketij vendimi mund te paraqitni ankese ne Gjykatën Supreme te Republikës së Kosovës Brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes se vendimit nga PZAP-i.

